



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe
Monitorimit

Rihapet aplikimi për monitorues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes këtij njoftimi, rihap aplikimin për monitorues të fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025, për të plotësuar numrin e vakancës për Qarkun Elbasan, Bashkia Belsh:

QARKU	Bashkia	VENDET VAKANTE
Elbasan	Belsh	1

KRITERET E APLIKANTËVE:

- 1) Të jetë i padënuar,
- 2) Të ketë përfunduar studimet universitare ose të jetë duke ndjekur një program studimi në një nga institucionet e arsimit të lartë.
- 3) Të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike të paktën 2 (dy) vitet e fundit

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë aplikantët për pozicionin e punës, monitorues:

- a) Kërkesën për t'u emëruar si monitorues që përmban: qarkun për të cilin aplikon, përvojën e aplikantit dhe adresën e banimit, adresën e postës elektronike (e-mail) dhe numrin e tel./cel.,
- b) **Pashaportizimin,**
- c) Dëshmi penaliteti,
- d) Kopje të noterizuar të diplomës ose vërtetim që është duke ndjekur një program

studimi në një nga institucionet e arsimit të lartë të noterizuar,

- e) Kopje të dokumentit të identifikimit,
- f) Vetëdeklarim se nuk është anëtar i ndonjë partie politike për 2 (dy) vitet e fundit, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3 që i bashkëlidhët udhëzimit nr. 3, datë 3.11.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,
- g) Raport të aftësisë për punë,
- h) Fotokopje e certifikatës si monitorues në zgjedhje të mëparshme (nëse disponojnë).

AFATI PËR DORËZIM E DOKUMENTEVE:

31.01.2025 ora 12:00

MËNYRA E APLIKIMIT PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIN DO TË JETË



Me anë të postës zyrtare në adresën: Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr. 4, Tiranë.



Pranë institucionit të KQZ-së, në adresë: Rruga “Ibrahim Rugova”, nr. 4, Tiranë